




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-D/DPK
Br. Prot.	01-2762/12
Prot. No.	
Nr. l faq.	
Broj stranica	02
Nr. pages	
Data	03.08.2012
Datum	
Date	
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 28.03.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllët rasti më nr.AKK-03-5089/11, për z.Zejnel Morina, Drejtor i Departamentit të Administratës dhe Shërbimeve Ndihmëse në Spitalin Regjional në Gjakovë, për shkak se zyrtari i lartë publikë ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhjet.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në lëndën e trajtuar me nr.AKK-03-5089/11, të dyshuar për konflikt të mundëshëm të interesit janë ndërmarrë veprimet e nevojshme të parapara sipas Ligjit Nr.04/L-051 dhe atyre procedurale sipas nenit 18.1 të po këtij ligji.

Pas zhvillimit të procedurës, dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë publik, ka qenë pronarë dhe person i autorizuar në një biznesë privatë “Z.SH.EuroKonto” që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, ka paraqitur konflikt të interesit, andaj Agjencia kundër Korupsionit më shkresën e parë njoftuese e ka njoftuar zyrtarin se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjëndjes së mundëshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë që në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia

Në takimin e ballafaqimit të fakteve që kanë pasë zyrtarët e Agjencisë me z.Morina është deklaruar së nuk ka qenë i informuar së mundë të ketë konflikt të interesit, mirëpo është zotuar së brënda afatit ligjorë do ti marrë veprimet e parapara për ta shmangur konfliktin interesit.

Pasë këtyre procedurave z.Zejnel Morina me datën 22.03.2012,brenda afatit ligjorë ka sjellurë dokumentacionin që dëshmon se ka bërë ndryshimet në biznesë të kërkuara nga Agjencia kundër Korrupsionit qe deshmojnë se e ka shmangur Konfliktin e Interesit .

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

